

Titulli i lëndës: Vepra të zgjedhura të letërsisë moderne

| Informatat themelore për lëndën | |
|---------------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë, Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane |
| Titulli i lëndës: | Vepra të zgjedhura të letërsisë moderne |
| Niveli: | BA |
| Statusi i lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | Viti i III-të |
| Numri i orëve në javë: | 2+0 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | Sipas orarit |
| Mësimdhënësi: | Prof. asoc. Dr. Albulena Blakaj- Gashi |
| Të dhënat kontaktuese: | Tel: 038222970/ albulena.blakaj@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Lënda “Vepra të zgjedhura të letërsisë gjermane” ndihmon studentët të fokusohen te vepra të zgjedhura të letërsisë gjermane, kryesisht me ato që janë përkthyer e janë bërë të njohura në pjesën më të madhe të botës. Pra, janë kryesisht vepra që trajtojnë tema të ndryshme të përditshmërisë dhe me karakter më të thellë psikologjik që i bën më të afërta edhe për studentët sa u përket ideve dhe interesave. Te ky kurs, theksi vihet jo vetëm te vepra të zgjedhura të letërsisë gjermane, por janë të përfaqësuara të gjitha vendet gjermanofolëse. Analizohen e interpretohen vepra të zgjedhura, si: <i>Siddarta, Homo Faber, Vizita e zonjës plakë, Letra e një të panjohure, Në koloninë e ndëshkimit, Parfumi, Liebediener</i> , etj. të gjitha të autorëve më të njohur gjerman si: Herman Hesse, Max Frisch, Friedrich Dürrenmatt, Stefan Zweig, Franz Kafka, Patrik Süskind, Julia Frank, etj. Qëllim i lëndës, përveç njohjes me autorë e vepra gjithëgjermane, është poashtu që studentët të aftësohen t'i interpretojnë ato, njëkohësisht të mësohen të krijojnë mendim personal për veprat dhe ta shprehin atë. |

Qëllimet e lëndës:

- Lënda Vepra të zgjedhura të letërsisë gjermane ka për objektiv fokusimin të autorë e vepra të zgjedhura gjithëgjermane, kryesisht te ato që janë përkthyer e janë bërë të njohura në pjesën më të madhe të botës;
- t'i njohë studentët me autorët kryesorë të letërsisë gjermane të cilët zënë vend të rëndësishëm në letërsinë botërore;
- Njohja e studentëve me veprat më të njohura të letërsisë moderne gjermane, ndikimin e psikanalistëve dhe psikanalizës të shkrimtarët e veprat e përmendura, prapaskenën historike të zhvillimit të tyre, llojet kryesore letrare të periudhave,
- Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët të analizojnë dhe interpretojnë veprat letrare, të krijojnë mendim personal për veprat dhe ta shprehin atë

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të sukseshem të këtij kursi (lënde) studenti do të:

- dijë për autorët kryesorë të letërsisë moderne gjermane të cilët zënë vend të rëndësishëm në letërsinë botërore;

- dijë për ndikimin e psikanalistëve dhe psikanalizës të shkrimtarët e veprat e përmendura

- jetë në gjendje të shkruaj punime rreth temave nga letërsia moderne;

- mund të bëjë dallimin mes llojeve të ndryshme të krijimeve letrare;

- të krahasojë mes rrymave të ndryshme letrare të cilave iu takojnë autorët dhe veprat e zgjedhura;

- të zhvillojë debat me kolegët e tij rreth një teme nga letërsia;

| | |
|--|---|
| | - zhvillojë aftësinë e krijimit të mendimit të pavarur rreth një vepre letrare |
| | - të jetë në gjendje ta shprehë mendimin e krijuar për një temë a vepër të caktuar; |

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|--------------|-----------|----------------------------|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 22.5 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | 10min | 4 | 1 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi i seminarit | 1 | 10 | 10 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 15 | 15 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 10 | 20 |
| Përgatitja për provimin final | 15 | 1 | 15 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 2 | 1 | 2 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 1 | 1 |
| Total | | | 86.5:25= 3.46 3 ECTS |

| | |
|--------------------------------|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Përveq ligjeratave me 2 orë në javë studentët do të punojnë seminar për njërën nga veprat të cilën e zgjedhin vet nga lista e dhënë e cila ju dorëzohet qysh në fillim të semestrit. Kështu ata ndahen në grupe rreth një teme të veçantë. Gjatë orëve të ushtrimeve prezantohen punimet e bëra dhe për to diskutohet në klasë me ç'rast diskutohet si grup, si dhe secili student në veçanti. Diskutimi përfshin periudhat letrare të cilës i takojnë veprat, autorët, biografitë e tyre, krijimtarinë dhe vendin e tyre në letërsinë gjermane e botërore. |
|--------------------------------|---|

| | |
|-----------------------|--|
| Metodat e vlerësimit: | Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria e studentit 10%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 20%; Provimi final 70%. |
| Literatura primare: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat të përgatitura nga prof. ass. dr. Albulena Blakaj-Gashi 2. Zweig, Stefan: <i>Brief einer Unbekannten</i>, Fischer Taschenbuch Verlag; Auflage: 12, 2012 3. Zweig, Stefan: <i>Angst</i>, Fischer Taschenbuch Verlag; Auflage: 12, 2012 4. Schnitzler, Arthur: <i>Traumnovelle und andere Erzählungen (Fischer Klassik) Taschenbuch</i>, 2008 5. Hesse, Herman: <i>Siddarta</i>, Suhrkamp Verlag, 2004 6. Mann, Thomas: <i>Der Tod in Venedig</i>, FISCHER Taschenbibliothek, 2013 7. Frisch, Max: <i>Homo Faber, Ein Bericht</i>, Suhrkamp Verlag, Auflage: 81, 1977 8. Dürrenmatt, Friedrich: <i>Der Besuch der alten Dame</i>, Diogenes Verlag; Auflage: 32., Aufl., 1999 9. Kafka, Franz: <i>In der Strafkolonie</i>, Suhrkamp Verlag, 2006 10. Kafka, Franz: <i>Vor dem Gesetz</i>, Suhrkamp Verlag, 2006 11. Süskind, Patrik: <i>Das Parfum-Die Geschichte eines Mörders</i>, Diogenes, 1994 12. Frank, Julia: <i>Liebediener</i>, Fischer Taschenbuch Verlag; Auflage: 3, 2007 13. Schlink, Bernhardt: <i>Der Vorleser</i>, Diogenes Verlag, 2010 14. Blakaj, Albulena: <i>Goethe dhe receptimi i tij te shqiptaret, OM, Prishtine</i>, 2017 |

Hartimi i planit mësimor

| Java | Titulli i ligjëratës |
|---------|--|
| Java 1: | Einführung in dem Wahlfach: Vepra të zgjedhura të letërsisë moderne |
| Java 2: | STEFAN ZWEIG: “Angst” |
| Java 3: | STEFAN ZWEIG: “Amoklaufer” |
| Java 4: | STEFAN ZWEIG: “Brief einer Unbekannten” |
| Java 5: | Arthur Schnitzler: <i>Traumnovelle und andere Erzählungen</i> |

| | |
|----------|---|
| Java 6: | HERMAN HESSE: “Siddharta” |
| Java 7: | PATRIK SÜSSKIND: “Das Parfum-Die Geschichte eines Mörders” |
| Java 8: | PATRIK SÜSSKIND: “Das Parfum-Die Geschichte eines Mörders” |
| Java 9: | FRIEDRICH DÜRRENMAT: “Der Besuch der alten Dame” |
| Java 10: | THOMAS MANN: “Der Tod in Venedig” |
| Java 11: | MAX FRISCH: “Homo Faber” |
| Java 12: | FRANZ KAFKA: “Sämtliche Erzählungen” (“Vor dem Gesetz”) |
| Java 13: | FRANZ KAFKA: “Sämtliche Erzählungen” (“In der Strafkolonie”) |
| Java 14: | JULIA FRANK: “Liebediener” |
| Java 15: | BERNHARD SCHLINK Der Vorleser |

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.